

ALBCHROME HOLDING SH.P.K.

**Raporti i audituesit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare individuale më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

PËRMBAJTJA

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	4
1. INFORMACION MBI SHOQËRINË.....	5
2. BAZA E PËRGATITJES	6
3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME	6
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL	7
5. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET E HYRA NË FUQI.....	13
6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET ENDE JO NË FUQI.....	14
7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE.....	15
8. INVESTIME NË FILIALE DHE PJSËMARRJE	15
9. TË DREJTA NDAJ PALËVE TË LIDHURA.....	17
10. LLOGARI TË ARKËTUESHME	17
11. LLOGARI TË ARKËTUESHME E TË TJERA	17
12. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE	17
13. DETYRIME NDAJ PALËVE TË LIDHURA	17
14. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA.....	18
15. DETYRIME PËR TATIME DHE TAKSA	18
16. TË ARDHURA NGA DIVIDENDËT	18
17. TË ARDHURA TË TJERA.....	18
18. SHPENZIME PERSONELI	18
19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE	18
20. TATIMI MBI FITIMIN	19
21. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHËZUARA	19
22. PALËT E LIDHURA	19
23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR	20
24. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT	23



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NIUS: K61911012I
Rr. Ibrahim Rugova,
Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionerin e Albchrome Holding Shpk

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albchrome Holding Shpk ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datë 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllt me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvëç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvëç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nësë pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rr Ethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerim përfundime mbi përshtatshmérinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë së bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në reportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e reportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhdhuari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Albchrome Holding Shpk, përvetë tjetërave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Accountants
10 mars 2020
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Auditues Ligjor



ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2019

	Shënimë	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Aktivet			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	90,155	127,237
Investime në filiale dhe pjesëmarrje	8	<u>296,620,000</u>	<u>296,621,000</u>
Totali i aktiveve afatgjata		<u>296,710,155</u>	<u>296,748,237</u>
Aktive afatshkurtra			
Të drejtë ndaj palëve të lidhura	9	66,459,022	532,294,809
Llogari të arkëtueshme	10	9,000,000	3,600,000
Llogari të arketueshme të tjera	11	1,936,883	122,717
Mjete monetare dhe ekuivalente	12	959,697	11,197,897
Totali i aktiveve afatshkurtra		<u>78,355,602</u>	<u>547,215,423</u>
Totali i aktiveve		<u>375,065,757</u>	<u>843,963,660</u>
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		354,139,440	266,700,000
Fitimet e pashpërndara		<u>1,086,772</u>	<u>573,870,393</u>
Totali i kapitalit		<u>355,226,212</u>	<u>840,570,393</u>
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime ndaj palëve të lidhura	13	19,345,883	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	14	393,655	113,860
Detyrime për tatime dhe taksa	15	100,007	3,279,407
Totali i detyrimeve afatshkurta		<u>19,839,545</u>	<u>3,393,267</u>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		<u>375,065,757</u>	<u>843,963,660</u>

Pasqyrat Financiare në faqet 1 deri 4 janë firmosur dhe aprovuar më **28 Shkurt 2020** nga:

Blerina Daka



Administrator i Përgjithshëm NPT: LS1320006C

AlbCHROME
holding

Dallandyshë Ismaili



Përgjegjës i Financës

Pasqyra e pozicionit finanziar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënimë	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga dividentët	16	-	555,500,000
Të ardhura të tjera	17	6,000,000	12,021,014
Totali i të ardhurave		6,000,000	567,521,014
Shpenzime personeli	18	(2,107,713)	(3,504,642)
Shpenzime të përgjithshme administrative	19	(1,273,877)	(709,540)
Shpenzime amortizimi	7	(37,083)	(126,871)
Fitimi nga aktiviteti i shfrytëzimit		2,581,327	563,179,961
Të ardhura financiare		2,059,627	16,311,793
Shpenzime financiare		(3,192,829)	(2,383,100)
Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto		(1,133,202)	13,928,693
Fitimi para tatimit		1,448,125	577,108,654
Tatimi mbi fitimin	20	(325,695)	(3,202,602)
Fitimi neto për vitin finanziar		1,122,430	573,906,052
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse		1,122,430	573,906,052

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e pashpërndara	Totali
Më 1 janar 2019	266,700,000	640,243,394	906,943,394
Fitimi i vittit	-	573,906,052	573,906,052
Dividendë të paguar	-	(640,279,053)	(640,279,053)
Më 31 dhjetor 2018	266,700,000	573,870,393	840,570,393
Fitimi i vittit	-	1,122,430	1,122,430
Dividendë të paguar	-	(573,906,052)	(573,906,052)
Rritje kapitali	87,439,440	-	87,439,440
Më 31 dhjetor 2019	354,139,440	1,086,772	355,226,212

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese		
Fitimi para tatimit	1,448,125	577,108,654
<i>Rregullime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	37,083	126,871
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	700,920	-
Fitimi nga shitja e aktivit	-	(21,014)
Humbja nga zhvleresimi dhe fshirja e kuotave ne shoqeri me pjesemarrje	1,000	
	2,187,128	577,214,511
Ndryshimet në kapitalin qarkullues		
Zvogëlim në të drejta ndaj palëve të lidhura	465,134,867	95,953,246
Zvogëlim/(rritje) në llogari të arkëtueshme	(5,400,000)	1,200,000
Rritje në të arketueshme të tjera	(1,814,166)	(2,717)
Zvogëlim i llogarive të pagueshme	(8,153)	(587,732)
(Zvogëlim)/rritje i të pagueshmeve të tjera	287,948	(320,350)
(Zvogëlim)/rritje në detyrime ndaj palëve të lidhura	19,345,883	-
(Zvogëlim)/rritje i detyrimeve për tatime dhe taksa	(3,505,094)	(119,745)
Flukset neto nga veprimtarite e shfrytëzimit	476,228,413	673,337,213
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje kuatash në shoqëri me pjesëmarrje	-	(25,000,000)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-	(102,083)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	-	500,880
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	0	(24,601,203)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Shpërndarje dividenti	(573,906,052)	(640,279,053)
Rritja e kapitalit	87,439,440	-
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese	(486,466,612)	(640,279,053)
Rritja neto e flukseve të parasë	(10,238,199)	8,456,956
Mjete monetare në fillim të periudhës	11,197,896	2,740,940
Mjete monetare në fund të periudhës	959,697	11,197,896

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvèçse kur është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION MBI SHOQËRINË

Shoqëria "Albchrome Holding sh.p.k."(këtu më poshtë "Shoqëria") është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 15 janar 2015 pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L51320005G.

Objekti i Shoqërisë është administrimi dhe financimi i minierave, impianteve, uzinave dhe fabrikave. Aksioner i vetëm i shoqërisë është shoqëria Balfin sh.p.k. e cila zotëron 100% të aksioneve. Vlera e aksioneve të Shoqërisë me 31 dhjetor 2019 është 354,139,440 Lekë (2018: 266,700,000 Lekë) Me vendimin e ortakut të vetëm të Shoqërisë datë 20.12.2019 u miratua zmadhimi i kapitalit të shoqërisë. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria administrohet nga Znj. Blerina Daka.

Adresa kryesore e Shoqërisë është: Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati I, Ap 3.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 2 punonjës (2018: 2 punonjës).

1.1 Marrevëshjet koncessionare

Me nënshkrimin e marrëveshje koncessionare është krijuar shoqëria koncessionare "Albchrome shpk" themeluar më 4 prill 2000, më vendim të gjykatës së rrethit të Tiranës 23.729, për administrimin e të dyja kontratave koncessionare .

Më 25 shkurt 2013 ACR Holding SRL-Itali u ble plotësisht nga Balfin sh.p.k. Më 14 nëntor 2016 u bë transferimi brenda grupit i 100% të kuotave të shoqërisë koncessionare "Albchrome shpk" nga ACR Holding SRL-Itali (shitësi) tek Shoqëria ("Albchrome Holding shpk" - blerësi). Me transferimin e kuotave janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë.

Nëpërmjet miratimit me nr. prot. 5541/6 datë 11 nëntor 2016 Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka autorizuar transferimin e Marrëveshjes Koncessionare nga ACR Holding s.r.l. tek Albchrome Holding sh.p.k. si dhe barrësimin e kuotave të Shoqërisë Koncessionare "Albchrome shpk".

Në këtë mënyrë Shoqëria mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me marrëveshjet koncessionare të nënshkruara ndërmjet autoritetit kontraktues dhe shitësit (ACR Holding s.r.l.), si më poshtë:

- Më 1 qershor 2000 është marrë në zotërim koncessioni i tipit BOT (Ndërto-Opero-Transfero) për objektin e mëposhtëm për 30 vjet, një fabrikë ferro-kromi në Elbasan dhe dy miniera kromi në Përrenjas dhe Pojsk me një vlerë monetare prej 168.000 mijë Lekë. Kjo marrevëshje koncessionare eshte aprovuar me ligjin nr. 8590 date 23.03.2000 "Për miratimin e Marrëveshjes së Koncessionit të formës BOT për Uzinën e Ferrokromit në Elbasan dhe për Minierat e Kromit në Prrenjas e Projsk, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane Darfo s.p.a" dhe dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncessionarin kësaj marrëveshje".

- Më 22 qershor 2001 është marrë në zotërim koncessioni i tipit ROT (Rehabilito-Opero-Transfero), për objektin e mëposhtëm për 30 vjet, një fabrikë ferro-kromi në Bulqizë, një fabrikë mineralesh të çmuara në Bulqizë, një zonë e veçuar me minerale në Klos dhe fabrikën e ferro-kromit në Burrel me një vlerë monetare prej 248.000 mijë Lekë. Kjo marrëveshje koncessionare është aprovuar me Ligjin nr. Nr.8791, datë 10.5.2001, "Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të tipit ROT të minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit Klos dhe të uzinës së ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane Darfo s.p.a" dhe dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncessionarin kësaj marrëveshje".

- Më 25 korrik 2016. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi zgjatjen e periudhës së koncessionit deri më 31 dhjetor 2040.

Shoqëria nepërmjet shoqërisë koncessionare "Albchrome shpk" detyrohet që me përfundimin e periudhës së koncessionit t'i transferoj Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA) të rehabilituar objektet e marra në koncesion.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombe të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombe të Kontabilitetit ("BSNK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, shprehur në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe.

2.1 Shoqëri të kontrolluara dhe konsolidimi

Shoqëri të kontrolluara janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria, ndërkohe shoqëria ka dhe investime në sipërmarrje të përbashkëta ku ushtrohet kontroll i përbashkët. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejtë ose indirekt, që të drejtojë politikat operacionale dhe financiare të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitimet nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Shoqëria përgatit vëtëm pasqyra financiare individuale. Si shoqëri mëmë e Albchrome Sh.p.k, shoqëria ka zgjedhur të përdorë përjashtimin e IFRS për të përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara në të njejtën datë me pasqyrat e vecanta, meqenëse shoqëria mëmë e saj (Balfin Sh.p.k) harton pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik në përputhje me Standardet Ndërkombe të Raportimit Financiar.

Interesat në shoqëri të kontrolluara dhe sipërmarrje të përbashkëta janë të regjistruara me kosto në pasqyrat individuale.

Riorganizimi i grupit dhe transferimi i shoqërive të kontrolluara

Balfin sh.p.k si një shoqëri mëmë (holding) të një numri filialesh që i zoteron në mënyrë direkte ose indirekte, mund të ndërmarrë riorganizime të strukturezotëruese brenda kompanive të grupit. Këto ri-organizime kryhen për arsyet e ndryshme si përmirësimi i koordinimit midis bizneseve, përmirësimi i strukturës së mbikqyrjes se tyre, krijimi i shoqërive ligjore për të ushtruar një biznez specifik e të tjera.

Transferimet e pronësisë brenda grupit kur kontrolli efektiv nuk ndryshon, mund të bëhen me pagesë ose pa, në formën e kontributit apo shpërndarjes. Këto transferime dhe ristrukturime të formës ligjore të pronësisë nuk kanë asnjë ndikim në strukturen e konsoliduar të grupit dhe nuk shkaktojnë të ardhura apo shpenizme. Për këtë arsyet, këto transferime kryhen me vlerën kontabël në pasqyrat individuale të kompanive duke qënë se thelbi ekonomik i transaksionit është riorganizimi i grupit dhe jo gjenerimi i fitimit.

3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësimë dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njenë në periudhën në të cilën vlerësimi është rishkuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë pëershruar më poshtë.

Tatim fitimi

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kerkohet në përcaktimin e shumës së tatimit fitimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrime për çështje të pritshme të kontrollit tatimor bazuar në vlerësimet se tatime shtesë do mund të lindin si detyrime. Kur rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është ndryshe nga shumat e regjistruara fillimisht, diferencat do të ndikojnë në aktivin dhe detyrimin tatimor aktual dhe të shtyrë në periudhën kur bëhet përcaktimi.

ALBCHROME HOLDING SHPK

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçse kur është shprehur ndryshe)

3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME (VAZHDIMI)

Të ardhura të tjera

Shoqëria ka një kontratë shërbimi vetëm me Albchrome sh.p.k. ku zoteron dhe 100% të aksioneve, duke qënë kështu aksioneri i vetëm. Shërbimi lidhet me asistenca të ndryshme në lidhje me mbarëvajtjen e marëdhënieve koncesionare. Pas analizës së kontratës midis palëve, Shoqëria konkludoi se kjo marrëveshje nuk i ka të gjithë karakteristikat e SNRF 15. Të ardhura nga kontratat me klientët dhe prezantohet si të ardhura të tjera, së bashku me shifrat krahasuese.

Të ardhurat nga kjo kontratë njihen në mënyrë lineare gjatë vitit dhe vlera e shërbimit faturohet cdo muaj.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë përgatiten në Lekë, që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lekë, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë ështe vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë:

Monedha	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

(b) Aktivet afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjate material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii) Kostot vijuese

Kostoja e zevëndësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do te realizoje përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjeses zëvendesuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

iii) Amortizimi (vazhdim)

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Paisje Informatike 25%

Mjete Transporti 20%

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur në fillim, nuk njihet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij.

(c) Investime në shoqëri të kontrolluara dhe sipërmarrje të përbashkëta

i) Njohja dhe matja

Investimet në shoqëri të kontrolluara

Investimet në shoqëri të kontrolluara janë investime ku Shoqëria zoeron kontrollin. Treguesi i kontrollit eshte kreysisht zoterimi i mbi 50% te kaptialit aksionar. Kontrolli arrihet kur shoqëria është e ekspozuar ose ka të drejta për kthime të ndryshueshme nga përfshirja e saj me të investuarin dhe ka aftësinë për të ndikuar në këto kthime nëpërmjet fuqisë së saj mbi të investuarin. Për investimet ne shoqëri të kontrolluara shoqeria ka përdorur metodën e kostos, minus humbjet nga zhvlerësimi. Nga shitja e investimeve në shoqëri të kontrolluara, diferenca ndermjet cmimit të shitjes dhe vlerës kontabël njihet si fitim humbje e periudhës.

Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta

Investimet në sipërmarrje të përbashkëta janë marrëveshje ku Shoqëria ka ndarë me një shoqëri tjeter kontrollin e përbashkët mbi aktivitetin ekonomik të shoqërisë. Në bazë të marrëveshje palët kane të drejta në aktivet neto sipas kësaj marrëveshje. Kontrolli i përbashkët është ndarja, sipas një marrëveshjeje kontraktuale, e kontrollit mbi një aktivitet ekonomik, dhe ekziston vetëm kur vendimet strategjike financiare dhe të shfrytëzimit që lidhen me aktivitetin kërkojnë pëlgimin unanim të palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).

Investimet në sipërmarrje të përbashkëta njihen me metodën e kapitalit neto, në njohjen fillestare të investimit, ku në fillim njihet me kosto dhe vlera kontabël rritet apo ulet per te njohur pjesen e investitorit ne fitimin ose humbjen e të investuarit pas datës se blerjes.

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare invididuale dhe nuk ka bërë konsolidimin e investimeve në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, duke qene se konsolidimi do të kryhet nga shoqëria mëmë "Balfin shpk".

ii) Të ardhurat nga dividentët

Shoqëria njeh të ardhurat nga dividendet nga një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje është njihen në fitim ose humbje në të saj pasqyrat financiare invididuale të një njësie ekonomike nëse përcaktohet e drejta e saj e njësisë ekonomike për të arkëtar dividendin. Dividendi njihet në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur njësia zgjedh të njohe investimin ne shoqeri me pjesemarrje me metodën e kapitalit. Në këtë rast dividendi njihet si pakësim i vlerës kontabël neto të investimit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Instrumentat financiarë

Një instrument finansiar është çdo kontratë që krijon një aktiv finansiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv finansiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari te pagushme tregetare dhe të tjera, te arketushme dhe te pagushme nga njesite ekonomike te grupit.

Aktivet Financiare

i) Njohja dhe matja fillestare

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëperfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit finansiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose përtë cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike te standartit, Shoqëria mat një aktiv finansiar me vlerën e drejtë të tij plus kostot e transaksionit, kjo në rastin e një aktivi finansiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Në mënyrë që një aktiv finansiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëperfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti finansiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për manaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhon aktivet e saj finansiar në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

ii) Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes se mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategorit:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes OCI pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Aktivet financiare me koston e amortizuar

Shoqëria ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë. Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi finansiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare përmbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivit finansiar të jepin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se me kamatë) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlersimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABEL (VAZHDIM)

Aktivet Financiare (vazhdim)

i) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilët pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilët Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

ii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria ka vetëm të arkëtueshme me palët e lidhura ndaj dhe humbja e pritshme e kredisë (ECL) është vlerësuar si jomateriale.

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF se një aktiv financiar konsiderohet i borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë, megjithatë gjykimi bëhet rast pas rasti në varësi të kërkesave të likuiditetit të palëve të lidhura. Një aktiv financiar shlyhet kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme përikuiperimin e flukseve monetare kontraktuale.

Detyrimet Financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarjet, të pagueshme ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, dhe të tjera të pagueshme të cilat janë te gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

i) Matjet e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes, dhe nuk ka ndonjë hua apo huamarje.

ii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anullohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast nijhet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabel neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) nijhet si fitim ose humbje.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(d) Llogaritë e arkëtueshme

Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë të konsiderueshme që është e pakushtëzuar (dmth., kërkohet vetëm kalimi i kohës para pagesës së shumës). Referojuni politikave kontabël të aktiveve financiare në seksionin *b) Instrumentet financiarë*.

(e) Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjëndjet e arkës dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfaqësojnë para në arkë dhe bankë.

(f) Qiratë

Shoqëria vlerëson në fillim të cdo kontrate nëse është apo përmban një qira. Kjo ndodh në rastet kur një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar një aktiv të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shumë. Shoqëria përdorë një qasje të vetme në njojhen dhe matjen e të gjitha qirave, me përashtim të qirave afatshkurtra dhe atyre për të cilat aktivi bazë është me vlerë të ulët.

i) E drejta e përdorimit të aktivit

Shoqeria njeh të drejtën e përdorimit të aktivit në datën e fillimit të qirasë (p.sh data në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim). E drejta e përdorimit të aktivit do të njihet me kosto, duke zbritur amortizimin akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe rregullimet për ndonjë rivlerësim të detyrimit të qirasë. Kosto e të drejtës për përdorim të aktivit përfshinë vlerën e detyrimit të qirasë, cdo pagesë të bërë para ose në datën e fillimit të qirasë, kostot direkte fillestare, minus cdo stimul qiraje të marrë. E drejta e përdorimit të aktivit do të amortizohet me metodën lineare përgjatë periudhës më të shkurtër midis qiramarrjes dhe jetës së dobishme të aktivit.

ii) Detyrimi i qirasë

Në datën e fillimit, qiramarrësi duhet ta masë detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fiksë minus ndonjë stimul qiraje të marrë, pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga njeë indeks apo normë e matur fillimi si duke përdorur një nideks ose normë në datën e fillimit, dhe vlerat e pritshme për tu paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive. Gjithashtu pagesat e qirasë përfshijnë çmimin i ushtrimit të një opzioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opzioni.

Pagesat e qirasë duhet të skontohen duke përdorur *normën e interesit të përcaktuar të qirasë*, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi duhet të përdorë *normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit*.

Detyrimet e qirasë përfshihen si huamarrje me interes.

iii) Qiratë afatshkurtra dhe aktivet me vlerë të ulët

Shoqëria aplikon përashtimin në njojhen e qirave afatshkurtra për makineritë dhe paisjet (p.sh. ato qira që kanë një afat prej 12 muajsh apo më të shkurtër nga data e fillimit dhe nuk përbajn opzionin e blerjes). Gjithashtu aplikon përashtimin për qiratë me vlerë të ulët mbi qiratë e makinerive apo paisjeve të zyrës që konsiderohen me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë në qiratë afatshkurtra dhe qiratë me vlerë të ulët njihen si shpenzim me metoden lineare përgjatë afatit të qirasë.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

(h) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet dhe sigurimin shëndetsor në përputhje me legjislatacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse kur ndodhin.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesit nga fondet e investuara në depozita bankare, dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

(j) Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi përbëhet nga taksa aktuale dhe e shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, perveçse në rastet kur lidhet me elementë që nijhen direkte në kapital, në të cilat nijhet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatushëm te vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

5. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET E HYRA NË FUQI

Kompania ka aplikuar SNRF 16 për herë të parë që nga janari 2019. Natura dhe efektet e ndryshimit si rezultat i aplikimit të këtij standarti të ri të kontabilitetit janë pëershruar si më poshtë. Përvec ndryshimeve të përmendura më poshtë, politikat kontabël të zbatuara janë konsistente me ato të një viti më parë.

Disa amendime të tjera dhe interpretime të zbatuara për herë të parë në 2019, por nuk kanë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka zbatuar më herët ndonjë standart, interpretim apo amendim që është nxjerrë, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 Qiratë është nxjerrë në Janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përbën qira, KIS-15 Qiratë Operacionale-Incentivat dhe KIS-27 Vlerësimi i Subtancës së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njojen, matjen, prezantimin dhe shpalosjesn e qirave dhe kërkon që qiradhënsi të kontabilizoj për të gjitha qiratë nën një zë të vetëm në bilanc, njëloj si kontabilizimi për qiratë financiare sipas SNK 17.

Standardi përfshinë dy përjashtime njojheje për qiramarrësin-qiratë me vlerë të ulët (p.sh. kompjuteri personal) dhe qiratë afatshkurtër (p.sh. qiratë me afat maturimi 12 muaj ose më pak). Në datën e fillimit të qirasë, qiramarrësi njeh detyrimin për të kryer pagesat e qirasë (p.sh. detyrimi i qirasë) dhe një aktiv që përfaqëson të drejtën për të përdorur aktivin përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. (p.sh. aktiv me të drejtë përdorimi) Qiramarrësit duhet të njojin vecmas shpenzimet e interesit për detyrimin e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit për të drejten e përdorimit të aktivit.

Kontabilizmi i qiradhënsit sipas SRNF 16 është kryesish i pa ndryshuar nga kontabilizimi sipas SNK 17. Qiramarrësi do të vijoj te klasifikoj te gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim klasifikimi si tek SNK 17 dhe dallimin midis dy tipeve të qirasë: qira financiare dhe operacionale.

Nje qiramarrës mund të zgjedhi të zbatoj standardin duke përdorur mënyrën në mënyrë retrospektive për çdo periudhë raportimi të paraqitur ose në mënyrë retrospektive, duke njojur efektin e akumuluar të zbatimit filletar të këtij Standardi në datën e zbatimit për herë të parë.

Menaxhimi ka kryer një vlerësim mbi efektet e zbatimit të standardit të ri SNRF 16 dhe gjykon që ky standard nuk ka impakt për Shoqërinë. Shoqëria ka vetëm një kontratë qiramarrje për zyrat qëndrore për të cilat është aplikuar përjashtimi për njojen, si qira me vlerë të ulët.

KIRFN 23 “Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat”

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimit. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veçmas;
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore;
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore;
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një entitet duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore të pasigurta. Metodologjia që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzpcionit.

Shoqëria zbatojë interpretimin nga data 1 janar 2019. Meqenëse Shoqëria vepron në një mjesid tatimor në ndryshim, zbatimi i Interpretimit mund të ndikojë në pasqyrat e saj financiare dhe në zbulimet e kërkura. Përveç kësaj, Shoqëria është duke vlerësuar krijojimin e proceseve dhe procedurave për të marrë informacionin që është i nevojshëm për të zbatuar Interpretimin në kohën e duhur.

6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET ENDE JO NË FUQI

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqeria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqeria planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

- **Kuadri Konceptual i standardeve SNRF** – BSNK ka nxjerrë Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar të rishikuar më 9 mars 2018, i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.
- **SNRF 3: Kombinimet e Biznesit** – BSNK ka nxjerrë amendimet mbi Përkufizimi i Biznesit për kombinimet e biznesit të cilat në datën e blerjes janë në periudhën e parë raportuese, i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.
- **SNK 1 Paraqitura e Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet ne Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i “materialitetit”**, i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.
- **Reforma e Standardit të Normës së Interesit – SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7** - detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe mund te zbatohet në retrospektive.
- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimit**, detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020.
- **Amendimet e SNRF 10 dhe SNK 28: Shitia ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe Investimit të tij në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta**, data e hyrjes ne fuqi eshte shtyre per një afat te pacaktuar.

ALBCHROME HOLDING SHPK**Shënimë mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Mjete transporti	Paisje kompjuterike	Totali
Kosto			
Me 1 janar 2018	617,743	70,475	688,218
Shtesa	-	102,083	102,083
Shitje	(617,743)	-	(617,743)
Më 31 dhjetor 2018	-	172,558	172,558
Shtesa	-	-	-
Shitje	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	-	172,558	172,558
Amortizimi i akumuluar			
Me 1 janar 2018	53,195	3,132	56,327
Amortizimi për vitin	84,682	42,189	126,871
Më 31 dhjetor 2018	(137,877)	-	(137,877)
Amortizimi për vitin	-	45,321	45,321
Më 31 dhjetor 2019	-	37,083	37,083
Vlera kontabel neto:			
Më 31 dhjetor 2018	-	127,237	127,237
Më 31 dhjetor 2019	-	90,155	90,155

8. INVESTIME NË FILIALE DHE PJESEMARRJE*Investime në shoqëri të kontrolluara*

Investimet në shoqëri të kontrolluara përfshijnë investime të mbajtura me kosto.

Albchrome shpk

Shoqëria zoteron 100% të aksioneve të shoqërisë "Albchrome shpk" në vlerën 271,620,000 Lekë (2018: 271,620,000 Lekë) duke qënë kështu aksioneri i vetëm. Shoqëria "Albchrome shpk" ushtron aktivitetin në fushën e shfrytëzimit dhe nxjerrjes së mineralit të kromit në zonën e Bulqizës si dhe në prodhimin dhe tregtimin e ferrokromit në uzinat e Burrelit dhe Elbasanit.

Informacione të përbledhura financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 (të shprehura në mijë Lekë) përfshijnë:

	31 dhjetor 2019 *të paaudituara	31 dhjetor 2018
Aktive afatshkurtra	3.234.718	5.115.224
Aktive afatgjata	7.440.526	6.907.991
Detyrime afatshkurtra	(3.099.026)	(3.594.082)
Detyrime afatgjata	(1.360.086)	(1.562.196)
Kapitali aksionar- 100% (2018: 100%)	6.216.131	6.866.939
Të ardhurat nga kontratat me klientët	7.630.557	11.246.563
Fitimi për vitin financier	(650.808)	1.236.862
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(650.808)	1.236.862

Albchrome Vlahen shpk

Bazuar në vendimin datë 08.11.2018, nr. 9200 të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Tiranë u pranua kërkesa për Miratimin e Procedurës së likujdimit të thjeshtëzuar për shoqërinë "Albchrome Vlahën" shpk. Shoqëria zotëronte 100% të aksioneve të shoqërisë "Albchrome Vlahën" shpk në vlerën 1.000 Leke. Investimi në shoqeri te kontrolluara nuk kanë detyrime të kushtëzuara apo angazhime kapitali më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. INVESTIME NË FILIALE DHE PJESËMARRJE (VAZHDIM)***Investime me pjesëmarrje në sipërmarrje të përbashkëta***

Investimet me pjesëmarrje të përbashkëta përfshijnë investime të mbajtura me kosto.

Vlahën Mining shpk

Në 12 mars 2018 (data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit) Shoqëria ka hyrë në një marrëveshje të llojit sipërmarrje e përbashkët, ku zotëron 50% të aksioneve të shoqërisë "Vlahen Mining shpk" në vlerën 25,000,000 Lekë dhe 50% të aksioneve zotërohen nga shoqëria Ekin Maden Ticaret Ve Sanayi Anonim Sirketi, duke zotëruar kështu kontroll të përbashkët. Shoqeria "Vlahen Mining shpk" operon në sektorin e nxjerrjes së mineraleve të tjera jo-metalore, në minierën e kromit në Vlahën, Qarku Kukës. Investimi në sipërmarrje të përbashkëta nuk ka detyrime të kushtëzuara apo angazhime të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

Informacione te permblehdhura financiare me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 (të shprehura në mijë Lekë) përfshijnë:

	31 dhjetor 2019 *të paaudituara	31 dhjetor 2018
<i>Aktive afatshkurtra</i>	62.972	23.625
<i>Aktive afatgjata</i>	77.669	21.040
<i>Detyrime afatshkurtra</i>	(153.755)	2.722
<i>Detyrime afatgjata</i>	(683)	2.537
Kapitali aksionar- 50% (2018: 50%)	(13.797)	39.406
Të ardhurat nga kontratat me klientët	19.185	1.673
Fitimi për vitin financier	(63.797)	(10.594)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(63.797)	(10.594)

ALBCHROME HOLDING SHPK**Shënimë mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

9. TË DREJTA NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Vlahen Mining shpk	65,781,520	-
Albchrome shpk	677,502	326,938,658
Balfin shpk	-	203,274,911
Albchrome Vlahen shpk	-	2,081,240
Totali	66,459,022	532,294,809

Vlera prej 677,502 Lekë me 31 dhjetor 2019 (31 dhjetor 2018: 326,938,658 Lekë) përfaqëson vlerën e dividentit të pa têrhequr lidhur me rezultatet financiare të shoqërisë Albchrome sh.p.k për vitin 2018 sipas vendimit të Asamblesë.

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme në vlerën 9,000,000 Lekë (2018: 3,600,000 Lekë) përbëhet nga të drejtat ndaj Albchrome shpk për shërbimet e konsulencës dhe manaxhimit.

Shoqeria nuk ka parashikuar humbjet të pritshme të kredisë (ECL) për llogaritë e arkëtueshme pasi këto të drejta janë kundrejt një shoqërie, palë e lidhur dhe humbjet e pritshme vlerësohen si jomateriale , pasi gjykohet që ka mundësi për arkëtimin e flukseve monetare. (ref. shënim 4, (d))

11. LLOGARI TË ARKËTUESHME E TË TJERA

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagim tatim fitimi	1,815,050	-
Parapagim i tatimi mbi të ardhurat personale	78,231	78,231
Parapagim i sigurime shoqërore dhe shëndetësore	43,602	44,486
Totali	1,936,883	122,717

Të arkëtueshmet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ju përkasin balancave kreditore me tatimet për shkak të parapagimeve të këtyre detyrimeve në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

12. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE

Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Vlera në arkë	18,874	34,235
Vlera në banka	940,823	11,163,662
Në Lekë	144,319	10,003,473
Në Usd	5,490	22,324
Në Euro	791,014	1,137,865
Totali	959,697	11,197,897

Shoqëria ka vetëm një llogari bankare të hapur pranë bankës Raiffeisen Bank sh.a. në monedhën Lekë, USD dhe Euro.

13. DETYRIME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 janë në vlerën 19,345,883 Lekë, (2018: 0 (zero) Lekë) ku përfshihen detyrimet për divident të pagueshmë.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

14. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA

Llogari të pagueshme dhe te pagueshme te tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme	76,210	84,363
Llogari të pagueshme të tjera	317,445	29,497
Totali	393,655	113,860

Llogari të pagueshme më 31 dhjetor 2019 prej 76,210 Lekë (2018: 84,363 Lekë) përfshijn detyrimet ndaj furnitorëve vendas për shërbimet e marra gjatë vittit. Të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 prej 317,445 Lekë (2018 29,497 Lekë) përfshijn detyrimet për pagat e pa paguara në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

15. DETYRIME PËR TATIME DHE TAKSA

Detyrime për tatime dhe taksa përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tatim fitimi i pagueshëm	-	3,082,602
TVSH e pagueshme, neto	100,007	196,805
Totali	100,007	3,279,407

16. TË ARDHURA NGA DIVIDENDËT

Të ardhurat nga dividendi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor janë 0 Lekë (2018: 555,500,000 Lekë) dhe përfaqësojnë të ardhurat nga investimi në Albchrome shpk.

17. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhurat nga kontratat me klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë në vlerën 6,000,000 Lekë (2018: 12,000,000 Lekë) përfaqësojnë shërbimet e manaxhimit dhe konsulencës për shoqërinë Albchrome shpk.

18. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Paga dhe shpërblime	2,085,818	3,301,671
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	8,064	111,658
Shpenzime të tjera stafi	13,831	91,313
Totali	2,107,713	3,504,642

19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Shpenzime të përgjithshme administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme	700,920	-
Shpenzim për qira	195,523	199,091
Shpenzime konsulence	186,125	-
Tarifa dhe taksa vendore	101,000	101,000
Shpenzime karburanti	-	113,300
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	14,179	105,614
Shpenzime të tjera	65,297	100,502
Mirëmbajtje dhe riparime	10,833	81,683
Shpenzime ligjore dhe noterie	-	8,350
Totali	1,273,878	709,540

ALBCHROME HOLDING SHPK**Shënimë mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

20. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin i llogaritur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas legjislacionin fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 eshte 15% (2018: 15%).

	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit		1,448,126		577,108,654
Tatimi fillestar me 15%	15.00%	217,219	15.00%	86,566,298
<i>Axhustime:</i>				
Efekti i të ardhurave të patatueshme	0.00%	-	(14.44)%	(83,325,000)
Efekti i shpenzimeve të panjohura	0.15%	108,476	0.00%	12,446
Efekti i humbjeve të mbartura	0.00%		(0.01)%	(51,143)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15.15%	325,695	0.55%	3,202,602

Të ardhurat e patatueshme në 2018 i përkasin të ardhurave nga dividendët që Shoqëria ka përfituar nga shpërndarja e fitimit të Albchrome sh.p.k.

21. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHËZUARA**Cështje gjyqësore**

Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij reporti nuk ka çështje të rëndësishme ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

Angazhimet operative të qirasë - Shoqëria si qiramarrëse

Shoqëria ka vetëm një kontratë qiraje për zyrat qëndrore me një afati 3 vjecar. Kontrata e qirasë maturohet brenda një afati 12 muajor por Shoqëria vlerëson që ekziston mundësia që kontrata e qirasë të rinovohet vijoj përtëj këtij afati. Megjithatë, Shoqëria për shkak të vlerës së ulët aplikon përjashtimin në njohjen e qirasë.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Brenda vittit	32,089	236,966
Pas një viti por jo më shumë se pesë vite	-	39,494
Totali	32,089	276,460

22. PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura të Grupit Balfin. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në termë tregtarë dhe në normat e tregut. Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga transaksionet me Albchrome shpk, Balfin shpk dhe Neptun shpk. Të arkëtueshmet me palët e lidhura konsiston në të ardhurat nga shërbimet e konsulencës, të arkëtueshmet për divident të dekluaruar por akoma të papaguar, ndërkohë detyrimet i përkasin blerjeve për nevoja operative nga kompanit brenda grupit.

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

22. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Të drejta:</i>		
Llogari të arkëtueshme	9,000,000	3,600,000
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	66,459,022	531,918,489

Detyrime:

Llogari të pagueshme	13,831	19,254
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	19,345,883	-

Volumi me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Shitje:</i>		
Të ardhura te tjera	6,000,000	12,000,000
Totali	6,000,000	12,000,000
<i>Blerje:</i>		
Aktive afatgjata materiale	-	116,073
Shpenzime të tjera të personelit	13,831	-
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	206,357	206,174
Totali	220,188	322,247

23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit, dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe manaxhimin e rrezikut dhe manaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollot e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontroll konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Meqë Shoqëria ka marrëdhënie vetëm me palët e lidhura risku i kredisë është i ulët. Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta matet në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e balancave të llogarive të arkëtueshme. Mosarkëtimi i llogarive të arkëtueshme nuk është probable ndaj dhe shoqëria nuk llogarit zhvlerësim.

ALBCHROME HOLDING SHPK**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçese kur është shprehur ndryshe)

23. Manaxhimi i rrezikut finansiar (vazhdim)**Rreziku i kredisë (vazhdim)****Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë**

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë.

Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të drejta ndaj palëve të lidhura	66,459,022	532,294,809
Të arketueshme të tjera	1,936,883	122,717
Llogari të arkëtueshme	9,000,000	3,600,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë	959,697	11,197,896
Totali	78,355,602	547,215,422

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjëndje të përbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimin e likuiditetit të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm. Githashtu, ajo nuk ka detyrime të rendësishme ndaj palëve të treta.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Aktivet dhe detyrimet financiare, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019			
	Me pak se 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	66,459,022	-	66,459,022
Llogari të arkëtueshme	9,000,000	-	-	9,000,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë	959,697	-	-	959,697
Totali	9,959,697	66,459,022	-	76,418,719
Llogari të pagueshme	(76,210)	-	-	(76,210)
Totali	(76,210)	-	-	(76,210)
Hendeku i Likuiditetit	9,883,487	66,459,022	-	76,342,509

ALBCHROME HOLDING SHPK

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

23. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Eksposimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2018			
	Me pak se 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	532,294,809	-	532,294,809
Llogari të arkëtueshme	3,600,000	-	-	3,600,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,197,896	-	-	11,197,896
Totali	14,797,896	532,294,809	-	547,092,705
 Llogari të pagueshme	 (84,363)			 (84,363)
Totali	(84,363)	 -	-	 (84,363)
Hendeku i Likuiditetit	14,713,533	532,294,809	-	547,008,342

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objktivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se eksposimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i cmimeve te mineraleve

Shoqeria është investuese në industrine minerare, industri që është tepër sensitive ndaj luhatjeve të cmimit të tregut të mineraleve. Një rënie e theksuar në vlerë, mund të ndikojë në vlerën e investimeve të shoqërisë në filalet që operojne veprimtarine minerare.

Shoqëria monitoron efektin e cmimeve të mineraleve në treg. Megjithatë, vlera e të ardhurave të pritshme nga filialat është shumë herë më e madhe se kostoja e investimeve dhe investimeve në kapitalin e filialeve dhe nuk egziston asnje tregues se kjo kosto investime nuk do të jetë e rikuperueshme.

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria nuk përballet me rrezikun e normës së interesit pasi nuk ka huamarrje në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në Euro dhe Dollar nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e mbrojti Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

Eksposimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019			
	Lek	Euro	Dollarë	Totali
Të drejta ndaj palëve të lidhura	677,502	-	65,781,520	66,459,022
Llogari të arkëtueshme	9,000,000	-	-	9,000,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë	163,193	791,014	5,490	959,697
Totali	9,840,695	791,014	65,787,010	76,418,719
 Llogari të pagueshme	 (76,210)		-	 (76,210)
Totali	(76,210)	 -	-	 (76,210)

ALBCHROME HOLDING SHPK**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përvçse kur është shprehur ndryshe)

23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Rreziku i tregut (vazhdim)**

	Më 31 dhjetor 2018			
	Lek	Euro	Dollarë	Totali
Të drejta ndaj palëve të lidhura	532,267,353	27,456	-	532,294,809
Llogari të arkëtueshme	3,600,000	-	-	3,600,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë	10,037,707	1,137,865	22,324	11,197,896
Totali	545,905,060	1,165,321	22,324	547,092,705
 Llogari të pagueshme	 (63,000)	 (21,363)	 -	 (84,363)
Totali	(63,000)	(21,363)	-	(84,363)

Analiza e ndjeshmërisë

Me anën e manaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2019 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e kursit te kembimit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera me -/+ 5% do sillte një ndryshim prej 3,3286,901 Lek (2018: 58,314 Lek) në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

Analiza e ndjeshmërisë nga ndryshimi i kursit të këmbimit**Efekti në fitimin para tatimit**

	2019	2018
Rritje me (5%)	3,328,901	58,314
EUR	39,551	57,198
USD	3,289,350	1,116
Rënje me (5%)	(3,328,901)	(58,314)
EUR	(39,551)	(57,198)
USD	(3,289,350)	(1,116)

24. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që mund të kërkojnë ndonjë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.